

VENDIM
Nr. 441, datë 22.5.2013

PËR IMITIMET E RREZIKSHME¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndalimin e vendosjes dhe bërjes së disponueshme në treg, si dhe importit apo eksportit të imitimeve të rrezikshme, të cilat, duke u paraqitur ndryshe nga çfarë janë, rrezikojnë shëndetin apo sigurinë e konsumatorëve.

2. Për qëllim të këtij vendimi, “Imitime të rrezikshme” konsiderohen produktet, të cilat megjithëse janë joushqimore, kanë formë, aromë, ngjyrë, pamje, paraqitje, paketim, etiketim, vëllim apo madhësi të tilla që ka mundësi që konsumatorët, kryesisht fëmijët, t’i ngatërrojnë me produktet ushqimore dhe, si pasojë, t’i futin në gojë, t’i thithin ose t’i gëlltitin, gjë që mund të jetë e rrezikshme dhe të shkaktojë asfiksi, helmim, apo shpim/çarje ose bllokimit të traktit tretës.

3. Ngarkohet struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, e parashikuar në legjislacionin për sigurinë e përgjithshme të produkteve, për:

- a) ndalimin e vendosjes dhe bërjes së disponueshme në treg të imitimeve të rrezikshme;
- b) marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të siguruar tërheqjen nga tregu dhe kthimin mbrapsht nga konsumatorët të imitimeve të rrezikshme;
- c) njoftimin e ministrisë përgjegjëse në fushën e tregtisë, në rast të marrjes së masave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike të vendimit.

4. Ngarkohen autoritetet doganore për të siguruar ndalimin e eksportit dhe importit të imitimeve të rrezikshme dhe njoftimin e strukturës përgjegjëse, në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 10 480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit nga 1 janari 2014.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

¹ Direktivë e Këshillit, datë 25 qershor 1987, për përafrimin e ligjit të shteteve anëtare mbi produkte që, duke u paraqitur ndryshe nga çfarë janë, rrezikojnë shëndetin apo sigurinë e konsumatorëve. Numri Celex 31987L0357, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 218, datë 11.7.1987, faqe 0049-0050.